

Shërbimi
Senatit
Planar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 3365 prot.

Tiranë, më 10.11.2025

Lënda: Depozitim projektligji

Drejtuar: **z. NIKO PELESHI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, ju paraqes projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

DEPUTETI PROPOZUES

OLSI KOMICI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

NR. ____/2025

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,
të ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas shkronjës “j”, shtohet shkronja “j/1” me këtë përmbajtje:

j/1) “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të kandidatit për magjistrat ose magjistratit.”

2. Pas shkronjës “k” shtohen shkronjat “k/1”, “k/2” dhe “k/3” me këtë përmbajtje:

“k/1) “Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me kandidatin për magjistrat ose magjistratin, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për kandidatin për magjistrat ose magjistratin.

k/2) “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër

pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:

i) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;

ii) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

k/3) “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me kandidatin për magistrat ose magistratin, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

3. Pas shkronjës “m”, shtohet shkronja “m/1” me këtë përmbajtje:

“m/1) “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e kandidatit për magistrat ose magistratit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, mbi burimin e të ardhurave;

Neni 2

Në nenin 32 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë;

1. Në pikën 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

“Verifikimi i plotë i pasurisë dhe figurës përfshin, vlerësimin e saktësisë së deklarimit dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për kandidatin për magistrat dhe për personat e lidhur të tij, identifikimin e kontakteve të papërshtatshme të kandidatëve me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe identifikimin e sjelljeve të papërshtatshme etike dhe morale të kandidatëve, të cilat cenojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.”.

2. Në pikën 2, fjala “prokuroria” zëvendësohet me togfjalëshin “Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria së Posaçme kundër Krimit të organizuar dhe korrupsionit, Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të klasifikuar”.

3. Pas pikës 2 shtohet pikat 2/1, 2/2, dhe 2/3 me këtë përmbajtje:

“2/1. Kandidati, brenda 10 ditëve nga data e publikimit të listës përfundimtare, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë:

a) Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë për kontrollin e pasurive të kandidatëve në institucionet e drejtësisë, në përputhje me nenin 5 pika 1 të ligjit “Për deklarimin të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe;

b) Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

2/2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe

nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundimin të kontrollit, por jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e deklaratës nga kandidati sipas pikës 2/1 të këtij neni, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit përgatit raportin për kandidatin dhe e përcjell pranë Këshillit përkatës.

2/3. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit sipas ligjit brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularit të vetëdeklarimit. Në përfundim të procedurës së verifikimit Autoriteti harton raportin për kandidatin, dhe e përcjell pranë Këshillit përkatës.”.

Neni 3

Në nenin 35, pika 1, shkronja “c”, shtohet fjalia e dytë me përmbajtje si më poshtë:

“Verifikimi kryhet për periudhën kohore që fillon nga data e përfundimit të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, sipas nenit 32, të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 43, pas pikës 11, shtohet pika 11/1 me këtë përmbajtje:

“Këshilli, për efekt të transparencës, publikon vendimin e lëvizjes paralele në faqen zyrtare të internetit. Përgjithshëm, nuk publikohen të dhënat sensitive sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

Neni 5

Në nenin 47, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“Këshilli, për efekt të transparencës, publikon vendimin e ngritjes në detyrë në faqen zyrtare të internetit. Përgjithshëm, nuk publikohen të dhënat sensitive sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

Neni 6

Në nenin 52, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 4, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastin e përzgjedhjes së kryetarit të prokurorisë Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të japë opinion të arsyetuar bazuar mbi fakte mbi kandidatin”.

2. Në pikën 9, pas togfjalëshit “nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës” shtohet togfjalëshi “ose që kanë masë disiplinore në fuqi”.

3. Pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me përmbajtje si më poshtë:

“10/1. Në rastin e përzgjedhjes së drejtuesit të prokurorisë, përveç vlerësimit të kriterëve të renditura në shkronjat “a” deri “c” të pikës 10 të këtij neni, merret në konsideratë edhe opinioni i arsyetuar bazuar mbi fakte mbi kandidatin, i paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm”.

Neni 7

Në nenin 53, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 7, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ky rregull nuk zbatohet për magistratët e komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

2. Në pikën 8, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Periudha e komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk mund të jetë më shumë se 15 vjet”.

Neni 8

Në nenin 54, në pikën 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rast të komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kufizimet kohore rregullohen sipas pika 7 dhe 8, të nenit 53 të këtij ligji.”

Neni 9

Në nenin 55 bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“Magjistratët që në kohën e komandimit kanë ushtruar funksionin për jo më pak se 10 vjet, prej të cilave të cilave jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar ose prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si magistrat i komanduar sipas këtij ligji mund të komandohen në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“Magjistrati mund të komandohet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një afat 7 vjeçar. Në përfundim të afatit 7 vjeçar inspektori ka të drejtë të kërkojë zgjatjen e afatit për një periudhë tjetër 7 vjeçare, në rast se magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional si inspektor.”.

4. Në pikën 6, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Përvoja si magistrat i komanduar pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë që i ka përfunduar afati i komandimit sipas ligjit konsiderohet vlerë e shtuar dhe do të ketë përparësi në vlerësimin dhe renditjen në lëvizjet paralele apo ngritjen në detyrë sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.”.

Neni 10

Në nenin 95, pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“Këshilli, për efekt të transparencës, publikon raportin e vlerësimit dhe vendimin përkatës në faqen zyrtare të internetit. Përgjashtimisht, nuk publikohen të dhënat sensitive sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale të

personave të tretë që nuk janë subjekte të këtij ligji mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për të dhënat personale.”.

Neni 11

Në nenin 149, pika 2 ndryshohet si më poshtë :

“Këshilli për efekt të transparencës publikon çdo vendim përfundimtar për çështje disiplinore në faqen zyrtare të internetit. Përfundimisht, nuk publikohen të dhënat sensitive sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale të personave të tretë që nuk janë subjekte të këtij ligji mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për të dhënat personale.”.

Neni 12

Shtohet neni 170/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 170/3

Dispozita tranzitore për caktimin e kryetarëve

1. Magjistratët të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ushtrojnë detyrën si kryetar gjykatë në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe administrative, si dhe drejtues të prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të apelit, konsiderohen ipso lege kryetarë dhe drejtues të emëruar në përputhje me këtë ligj, deri në 31 dhjetor 2028, me kusht që :

a) të kenë kaluar procesin e rivlerësimit në bazë të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendim konfirmimi në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, si dhe;

b) të kenë përmbushur detyrat lidhur me administrimin e institucionit brenda një kohe të arsyeshme dhe në mënyrë të kënaqshme sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kryetarët e gjykatave dhe Prokurori i Përgjithshëm për drejtuesit e prokurorive.

2. Vendimi sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, merret brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij neni.

3. Prokurori i Përgjithshëm informon Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vendimin shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni”.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R

NIKO PELESHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 96/2016 “PËR STATUSIN E
GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Kuvendi i Shqipërisë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ka miratuar ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si pjesë të paketës së ligjeve prioritare të reformës në sistemin e drejtësisë.

Ky ligj parashikon rregulla tërësore për përcaktimin e statusit të magjistratit duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet, mënyrën e pranimit dhe emërimit në sistem, evoluimin profesional deri në përfundimin e mandatit të magjistratit, mënyrën se si vlerësohet profesionalisht si dhe përgjegjësinë disiplinore bazuar në kritere objektive.

Parashikimet ligjore në këtë ligj janë në funksion të garantimit të pavarësisë, paanësisë dhe llogaridhënies së magjistratëve me qëllim ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë, profesionale, të besueshme dhe të orientuar drejtë shërbimit ndaj qytetarit.

Reforma në drejtësi është tashmë në vitin e 9 të zbatimit dhe institucionet e sistemit janë në fazën e konsolidimit të arritjeve të tyre. Gjatë zbatimit të reformës në tërësi dhe Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" institucionet e drejtësisë kanë hasur disa sfida që lidhen me mënyrën e funksionimit të tyre si institucione të pavarura, eficientë në ushtrimin e kompetencave kushtetuese, modalitetet për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të sistemit si dhe ndërveprimin me institucionet e tjera të sistemit. Këto sfida janë evidentuar edhe nga raportet e Komisionit Evropian.¹

¹ Screening Report 2022 *Judiciary and Fundamental Rights*, fq.37

https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf;

Rule of Law Report 2024: https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-c3d56cfe7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf;

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet të arrihen këto objektiva:

- ✓ Zbatimi i piketave të ndërmjetme (*interrim benchmarks*) të Komisionit Evropian;
- ✓ Adresimin e sfidave që lidhen me boshllëqet e krijuara në sistem në drejtimin e gjykatave/zyrave të prokurorisë (*ku pothuajse të gjitha gjykatat/zyra të prokurorive drejtohen nga zëvendëskryetar*) duke parashikuar një skemë kalimtare që i përgjigjet realitetit dhe zhvillimeve në sistem si dhe në funksion të zbatimit e hartës së re gjyqësore;
- ✓ Përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me funksionalitetin e ILD me qëllim përmbushjen e kompetencave kushtetuese dhe ligjore;
- ✓ Rritjen e transparencës së Këshillave në lidhje me publikimin e vendimeve për statusin e magjistratëve dhe nëpunësve civil gjyqësor nëpërmjet aplikimit të standardeve të harmonizuara me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;

II. PROCESI KONSULTATIV NË HARTIMIN E KËTIJ PROJEKTLIGJI

Propozimi për ndërmarrjen e nismës ligjore për ndryshimin e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar vjen si nevojë e adresimit të problematikave të lindura gjatë zbatimit të këtij ligji. Konkretisht, problematikat u raportuan në Komisionin e Çështjeve Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut gjatë raportimit vjetor të institucioneve në periudhën periudhën Maj/Qershor 2022/2023/2024 në zbatim të detyrimeve ligjore, si dhe në tryezat që u organizuan përpara miratimit të hartës së re gjyqësore.

Komisioni ngriti një grup pune të përbërë nga 5 deputetë, përkatësisht 3 të mazhorancës parlamentare dhe 2 të opozitës parlamentare: Klotilda Bushka Ferhati, Toni Gogu, Klevis Xhoxhi dhe Dhurata Tyli, Gazmend Bardhi. Me vendimin nr. 38/2023 të Byrosë së Kuvendit, u caktuan 5 ekspertë ligjorë për të asistuar nënkomisionin e krijuar për këto ndryshime ligjore.

Në vijim të një takimi koordinues me përfaqësues e institucioneve të drejtësisë, çdo institucion paraqiti me shkrim propozimet për shtesa dhe ndryshime në ligjin përkatës. Kërkesat e parashtruara nga institucionet iu nënshtruan diskutimeve të mëtejshme të thelluara duke adresuar dhe analizuar çdo kërkesë midis anëtarëve të nënkomisionit, ekspertëve të caktuar dhe përfaqësuesve të institucionit. Në total janë organizuar 10 takime gjatë periudhës Tetor 2022 - Shkurt 2023 në të cilat kanë qenë prezent edhe përfaqësues të misioneve ndërkombëtare që asistojnë zbatimin e reformës në drejtësi si Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe OPDAT.

Rule of Law Report 2025: https://commission.europa.eu/document/download/3732ae59-5ab4-48a6-a3e6-0ef9aa593863_en?filename=2025%20Rule%20of%20La%20Report%20-%20Country%20Chapter%20Albania.pdf

Në përmbyllje të këtyre takimeve, si dhe në zbatim të detyrave të caktuara nga nënkomisioni, ekspertët hartuar projektligjet përkatëse. Projektligjet, pasi u diskutuan me anëtarët nënkomisionit, iu dërguan për opinion partnerëve ndërkombëtar. Pas marrjes së komenteve me shkrim nga Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe OPDAT, në Shtator 2023, ekspertët përgatitën draftet e rishikuara që reflektonin sugjerimet e dhëna. Mbi këto drafte, partnerët ndërkombëtar, paraqitën komente të tjera që lidheshin me gjetjet e Raportit Screening si dhe atij për Shtetin e së Drejtës. Për sa më sipër, draftet iu nënshtuan sërish rishikimit me qëllimin reflektimin e këtyre sugjerimeve/komenteve.

Draftet u rishikuan në frymën e piketave të ndërmjetme të dakortësuara me BE-në dhe në bazë të komenteve të ardhura nga shërbimet e Komisionit Evropian (KE), gjatë periudhës Korrik-Tetor 2025 janë rishikuar nga ekspertë vendas dhe ekspertë ndërkombëtarë, të asistencës teknike të financuar nga BE, në reflektim të komenteve të KE. Këto propozime sillen si nisëm ligjore pranë Kuvendit të RSH dhe më pas do të trajtohen në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

III. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Neni 1

Ndryshimet në nenin 2 të ligjit, ku propozohet të shtohen shtohen përkufizimet për termat “Pasuri”, “Person i lidhur”, “Persona të tjerë të lidhur”, “Person i përfshirë në krimin e organizuar” dhe “Të ardhura të ligjshme” janë të ndërlidhura me trupëzimin e normave dhe praktikave të mira të procesit të rivlerësimit kalimtar (‘vettingut’) të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas kërkesave për përmbushjen e piketave të ndërmjetme.

Neni 2

Ndryshimet në nenin 32 synojnë trupëzimin e normave dhe praktikave të mira të procesit të rivlerësimit kalimtar (‘vettingut’) të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe qartësimin e procedurave, sipas kërkesave për përmbushjen e piketave të ndërmjetme.

Neni 3

Shtimi në shkronjën c të pikës 1 të nenit 35 synon saktësimin e periudhave kohore të verifikimit, për procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës para emërimit të magjistratit të diplomuar, periudhë e cila fillon nga data e kryerjes së procesit të fundit të verifikimit.

Neni 4

Në përmbushje të piketave të ndërmjetme dhe komenteve të KE për të siguruar transparencë lidhur me proceset e lëvizjeve paralele, është hartuar propozimi në nenin 43 që KLGJ dhe KLP, sipas rastit, për efekt të transparencës publikon vendimin e lëvizjes paralele në faqen zyrtare të internetit. Përfundimisht, sigurohet redaktimi i të dhënave sensitive, në kuptim të përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5

Në përmbushje të piketave të ndërmjetme dhe komenteve të KE për të siguruar transparencë lldhur me proceset e ngritjeve në detyrë, është hartuar propozimi në nenin 47 që KLGJ dhe KLP, sipas rastit, për efekt të transparencës publikon vendimin e ngritjes në detyrë në faqen zyrtare të internetit, me të njëjtën llogjikë si neni 5 më sipër. Përfshirja, sigurohet redaktimi i të dhënave sensitive, në kuptim të përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 6

Ndryshimet në nenin 52 synojnë të adresojnë disa shqetësime të ngritura nga Këshillat dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Kështu ndryshimet në pikën 4, ku pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “*Në rastin e përzgjedhjes së kryetarit të prokurorisë konsiderohet edhe opinioni i Prokurorit të Përgjithshëm për kandidatin*”, synojnë të përfshijnë PP në procesin e rizgjedhjes së kryetarit të zyrës së prokurorisë. Përfshirja e PP, në formën e dhënies së një opinioni, për vlerësim të mëtejshëm nga KLP së bashku me kriteret e tjera ligjore, i shërben ushtrimit të kompetencave të tij në mbarëvajtjen e punës organizative dhe administrative në prokurori si dhe në drejtim të vlerësimit të performancës së zyrave të prokurorisë parashikohet në nenin 148/b shkronja “b”, “c” e “ç” të Kushtetutës. Në të njëjtën kohë, ky ndryshim siguron bashkëpunim dhe ndërveprim institucional midis PP dhe KLP për procesin e rëndësishëm të përzgjedhjes së kryetarit të zyrës së prokurorisë.

Ndryshimet në pikën 9 të këtij neni sigurojnë që kandidatët që kanë që kanë *masë disiplinore në fuqi* të përjashtohen nga kandidimi. Ky kriter i shtohet kriterëve ekzistues që parashikon ligji sipas të cilave përjashtohen kandidatët që nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe figurës. Bashkë me shtesën që propozohet, ky nen garanton që në krye të zyrave të prokurorisë apo gjykatave të zgjidhen magjistratë me integritet të lartë etik dhe profesional. Shtimi i pikës 10/1 synon, që njësoj si në rastin e rizgjedhjes sipas pikës 4 më sipër, edhe në rastin e zgjedhjes për herë të parë për përzgjedhjes së kryetarit të prokurorisë, përveç vlerësimit të kriterëve të renditura në pikën 10 shkronja a) deri c), konsiderohet edhe opinioni i Prokurorit të Përgjithshëm për kandidatin prokuror.

Neni 7

Propozimi për ndryshime në nenin 53 vjen me synim incentivizimin e magjistratëve për t’iu nënshtruar komandimit pranë zyrës së ILD. Zgjatja e periudhës së komandimi nga një kohëzgjatjeje të zakonshme maksimale pesëvjeçare për emërimet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në një periudhë më të gjatë prej 7 vjetësh. Propozimi i ndërlidhur me ndryshimet e propozuara në nenin 55.

Gjithashtu, lejimi i magjistratëve të qëndrojnë të deleguar edhe pas përfundimit të mandatit të përgjithshëm 10 vjeçar të delegimit, ku në vend të saj të kenë një periudhë më të gjatë të mundshme prej 15 vitesh. Kjo do t’u mundësonte magjistratëve që janë afër daljes në pension,

por që tashmë kanë arritur limitin dhjetëvjeçar, të zgjasin delegimin e tyre në përputhje me rrethanat. Këto propozime në kompleks i përgjigjen piketavë të ndërmjetme të BE.

Neni 8

Propozimi për ndryshime në nenin 54 ndërlidhet me ndryshimet e parashikuara për në nenin 53 pika 7 dhe 8 si dhe me ndryshimet e propozuara në nenin 55.

Neni 9

Ndryshimet e propozuara në pikën 1 të nenit 55 synojnë harmonizimin e kriterëve të emërimit dhe statusin e inspektorëve magistratë pranë ILD me magistratët e Gjykatës së Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe Prokurorinë e Posaçme. Këto ndryshime janë të ndërlidhura me ndërhyrjet e propozuara në nenin 12 të ligjit nr. 96/2016.

Ndryshimi në pikën 7 të nenit 55 ndërlidhet me afatin 7 vjeçar të komandimit dhe janë të ndërlidhura me ndryshimet e propozuara në nenin 53 pika 7 dhe 8 si dhe nenet 54 dhe 55.

Ndryshimet që propozohen në nenin 55 janë në linjë me ato që propozohen në nenin 211 të Ligjit nr.115/2016. Ato synojnë të rrisin atraktivitetin për komandimin si magistrat pranë ILD-së nëpërmjet garancive ligjore që pasojnë periudhën e komandimit. Kështu, ndryshimet në pikën 6 parashikojnë se përvoja si inspektor i komanduar konsiderohet vlerë e shtuar dhe do të ketë përparësi në vlerësimin dhe renditjen në lëvizjet paralele apo ngritjen në detyrë sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 10

Ndryshimet që propozohen në nenin 95, pika 9 janë në të njëjtën linjë me ato që propozohen në nenin 190, pika 2 të Ligjit nr.115/2016. Ato adresojnë shqetësime të Këshillave, mediave dhe shoqërisë civile në lidhje me mënyrën e publikimit të anonimizuar të vendimeve të Këshillave që lidhen me vlerësimin profesional. Parashikimi ekzistues e bënte vendimmarrjen jo transparente dhe shkonte përtej parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatohej në disa raste në mënyrë jo uniforme nga të dy Këshillat. Për rrjedhojë, në rastet kur zbatohej detyrimi për anonimizim, njoftimi për publikun kishte një përmbajtje të pakuptueshme për publikun që nuk i shërbente transparencës në lidhje me aspekte të statusit të magistratit. Formulimi i propozuar krijon bazën ligjore për transparencë dhe është në linjë me parashikimet ligjore të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale duke garantuar redaktimin e të dhënave sensitive. Gjithashtu, garantohet mbrojtja e të dhënave personale për personat e tretë që nuk janë subjekte të ligjit, por që mund të përmenden në aktet e Këshillave.

Neni 11

Ndryshimet në nenin 149, pika 2 janë në linjë me ndryshimet në nenin 95, pika 9 të këtij ligji si dhe nenit 190, pika 2 të Ligjit nr.115/2016. Rregullimet në këtë rast prekin aspekte të publikimit të vendimeve disiplinore të magistratëve. Edhe në këtë rast vlejnë parashtrimet në nenin 95, pika 9 më sipër.

Neni 12

Propozimi vjen si një dispozitë kalimtare lidhur me caktimin e kryetarëve të gjykatave apo prokurorive, për një periudhë tranzitore nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe deri më 31 dhjetor 2028.

Neni 13

Ky nen parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit, në përputhje me rregullin e përgjithshëm të hyrjes së fuqi, shprehimisht hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

OLSI KOMICI

